



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1696/10 prot.

Datë 18.08.2026

V E N D I M
Nr. 997/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Edvin Simo	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.08.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar -Mall”, me Nr. REF-83274-04-24-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 7,493,400 (shtatëmilionë e katërqind e nëntëdhjetë e tremijë e katërqind) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Sherbimeve Publike Urbane Elbasan

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kejdi Solar” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar -Mall”, me Nr. REF-83274-04-24-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 7,493,400 (shtatëmilionë e katërqind e nëntëdhjetë e tremijë e katërqind) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Sherbimeve Publike Urbane Elbasan

Ankimues:

Operatori ekonomik “VASAA” SHPK me Nipt J62903470T dhe adresë: L. KRYENGRITJA E FIERIT, Fier.

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik “Kejdi Solar” SHPK me Nipt. M22828201S dhe adresë: Rruga e Re , Zona kadastrale nr 8524 nr pasurie 6/624-N2, Elbasan

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Sherbimeve Publike Urbane
Lagje Visarion Xhuvani, Rruga e Re, Elbasan

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II

Rrethanat e çështjes

II. 1. Në datën 27.04.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit prokurimit “E hapur e thjeshtuar -Mall”, me Nr. REF-83274-04-24-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 7,493,400 (shtatëmilionë e katërqind e nëntëdhjetë e tremijë e katërqind) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Sherbimeve Publike Urbane Elbasan.

II.2. Në datën 08.05.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 14.05.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Kejdi Solar” SHPK”	5,651,150 lekë	kualifikuar
2. “VASAA” SHPK	6,236,400 lekë	s’kualifikuar

II.4. Në datën 14.05.2026 operatori ekonomik “VASAA” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

“--OE VASAA SH.P.K. në përmbushje të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku bazuar në Nenin 26 pika 2 gërma h) dhe i) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit publik” duhet të deklarojë të dhënat e sakta të një automjeti të përshtatshëm për transportin e mallit objekt prokurimi dhe të dhënat e sakta të një punonjësi inxhinieri Elektrik të diplomuar në Inxhinieri Elektrike i punësuar në subjektin ofertues :

Konstatohet se në dokumentacionin e ngarkuar elektronikisht nga O.E. VASAA sh.p.k. tek seksionet e posaçme të Formularit të Vetëdeklarimit të deklarimit të disponimit të fuqisë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e kontratës dhe mjeteve të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, është deklaruar se i disponon por nuk janë deklaruar të dhëna të sakta të tyre me qëllim vlerësimin e tyre në raport me dokumentacionin provues që do të dorëzojë ofertuesi nëse do të kualifikohej i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

OE nuk ka përmbushur kriterin 1 sipas përcaktimeve të Nenit 26 pika 2 gërma (h) dhe (i) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 82 të LPP, për këto arsye OE VASAA SH.P.K. do të skualifikohet.

--OE VASAA SH.P.K. në përmbushje të kriterit 3.2 të Kapacitetit Teknik dhe Profesional, për të na dëshmuar se operatori ekonomik ofertues disponon një automjet të përshtatshëm për transportin e mallit objekt prokurimi, me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku bazuar në Nenin 26 pika 2 gërma i) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit publik” duhet të deklarojë të dhënat e sakta të një automjeti të përshtatshëm për transportin e mallit objekt prokurimi :

Konstatohet se në dokumentacionin e ngarkuar elektronikisht nga O.E. VASAA sh.p.k. tek seksionet e posaçme të Formularit të Vetëdeklarimit të deklarimit të disponimit të mjeteve të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, është deklaruar se i disponon por nuk janë deklaruar të dhëna të sakta të tyre me qëllim vlerësimin e tyre në raport me dokumentacionin provues që do të dorëzojë ofertuesi nëse do të kualifikohej i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Asnjë dokument tjetër provues nuk është ngarkuar nga O.E. në përmbushje të këtij kriteri.

OE nuk ka përmbushur kriterin 3.2 sipas përcaktimeve të Nenit 40 pika 5 gërma (ç) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP, për këto arsye OE VASAA SH.P.K. do të skualifikohet.

--OE VASAA SH.P.K. në përmbushje të kriterit 3.4 të Kapacitetit Teknik dhe Profesional, për të na dëshmuar se operatori ekonomik ofertues disponon një inxhinier elektrik të diplomuar në Inxhinieri Elektrike, me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku bazuar në Nenin 26 pika 2 gërma h) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit publik” duhet të deklarojë të dhënat e sakta të një inxhinieri elektrik të diplomuar në Inxhinieri Elektrike:

Konstatojmë se në dokumentacionin e ngarkuar elektronikisht nga O.E. VASAA sh.p.k. tek seksionet e posaçme të Formularit të Vetëdeklarimit të deklarimit të disponimit të një inxhinieri elektrik të diplomuar në Inxhinieri Elektrike, është deklaruar se i disponon por nuk janë deklaruar të dhëna të sakta të tyre me qëllim vlerësimin e tyre në raport me dokumentacionin provues që do të dorëzojë ofertuesi nëse do të kualifikohej i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Asnjë dokument tjetër provues nuk është ngarkuar nga O.E. në përmbushje të këtij kriteri.

OE nuk ka përmbushur kriterin 3.2 sipas përcaktimeve të Nenit 40 pika 5 gërma (b) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP, për këto arsye OE VASAA SH.P.K. do të skualifikohet.

--OE VASAA SH.P.K. në përmbushje të kriterit 4.3 të Kriteret e Tjera, për të na dëshmuar se operatori ekonomik duhet të paraqesë Katalogë ose fragmente të katalogëve të prodhuesit për listen e mallrave objekt prokurimi, në të cilën të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara dhe skedën teknike për mallrat sipas preventivit në të cilën duhet të paraqiten të dhëna të sakta të kodit të produktit dhe web i firmës furnizuese.

Konstatojmë se në dokumentacionin e ngarkuar elektronikisht nga O.E. VASAA sh.p.k. ka ngarkuar Katalogë në gjuhë të huaj e të papërkthyer në gjuhën shqipe.

OE nuk ka përmbushur kriterin 4.3 sipas përcaktimeve të pikës B/2 të Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikës për Gjuhën e Ofertës ku Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe, për këtë arsye OE VASAA SH.P.K. do të skualifikohet... ”.

II.5. Në datën 28.05.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.6. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor në datën 30.05, është dorëzuar ankesa me numër elektronik A/2026/6737 datë 30.05.2026 dhe me nr.1696 prot., datë 01.06.2026e operatorit ekonomik “VASAA” SHPK , ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “VASAA” SHPK dhe shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e

ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kejdi Solar” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar me argumentimin si më poshtë vijon:

“Autoriteti Kontraktor duke skualifikuar pa te drejte Oferten tone eshte ne shkelje te Nenit 77, Kërkesat per Kualifikim pika 1,4 pika 5, te Ligjit 162, date 23.12.2020

Shprehimisht ne kete nen thuhet :

Neni 77

Kërkesat për kualifikim

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.”*

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ne DST-ne e Kesaj Procedure Prokurimi Autoriteti Kontraktor Shprehimisht ka kerkuar Tek Krierte e vecanta te Kualifikimit qe :

3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë :

- Një automjet të përshtatshëm, për transportin e mallit; Për të cilat duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtëm :

-Aktin e pronësisë së mjetit përkatës Ose

-Kontratën noteriale të marrjes me qera të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo me qera) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit Teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Ky kriter do të përmbushet nga O.E. me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjetit, dorezohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një punonjës Inxhinier Elektrik të diplomuar në Inxhinieri Elektrike, të provuar përmes diplomës në këtë fushë, kontratës së punës dhe listëpagesave nga sigurimet shoqërore.

Ky kriter do të përmbushet nga O.E. me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues : diploma; kontratë pune dhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore,

për vërtetimin e kualifikimit dhe punësimit të punonjësit, dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Firma "VASAA" shpk ka Hedhur ne Sistem "Formularin Permbledhes te Vetdeklarimit ,shtojca 9 dhe :

" ka Deklaruar qe Disponon Ing.Elektrik dhe Automjet per ekzekutimin e kontrates, te cilat jane te listuara edhe tek Ekstakti Historiki Firmes I hedhur ne Sistem, dhe nese fitoj, do dorezoj kopje origjinale ose te noterizuar, ose nese me kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor" Autoriteti Kontraktor ka hamendesuar qe Firma "VASAA" shpk nuk disponon Inxhinier Elektrik dhe Automjet transporti, pasi nuk ka kerkuar ndonje sqarim apo dokument mbështetës për vetdeklarimin në zbatim të nenit 26,pika 7 të VKM 285 date 19.05.2021

Kërkesa gjate vleresimit nga AK bie ndesh me parimin e transparencës, barazise dhe modiskriminimit te operatoreve ekonomike pjesemarres, ,neni 2,neni 3, Ligjit 162 Te LPP-se .

Neni 2

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Autoriteti Kontraktor AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE, e ka paracaktuar Fituesin e Procedures duke Kualifikuar Firmen "Kejdi Solar" ne kundershtim me Nenin 77, Pika 1,pika5 te ligjit Nr 162 te LPP-se date 23.12.2020 , pasi kjo Firme nuk Ploteson Kriteret e Vecanta Te Kualifikimit ,Pika 3 kapaciteti Teknik dhe profesional,pika 4.2,

4.4,pika 4.5te dst-se

4.2.Nuk Disponon Autorizim të prodhuesit/ distributorit për çdo artikull të kërkuar (sipas preventivit),me të dhëna të plota të prodhuesit, si : telefon, fax, e-mail,website, ose /

distributorit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer e i noterizuar në gjuhën shqipe dhe të vërtetohet lidhjen ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit të Autorizuar.

4.4 Nuk Disponon Deklaratë Konfomiteti CE të produkteve për të treguar se materialet elektrike janë prodhuar në përputhje me direktivat e Komunitetit Europian.

4.5 Nuk Disponon ofertën teknike për mallrat objekt prokurimi, në formën e një table sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze me të dhënat si më poshtë :

-Emri i kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar nga prodhuesi, me mallrat e të cilit OE do të paraqitet në tender.

-Numri i faqes në Katalog të Firmës Prodhuese ku ndodhet artikulli.

-Numri (kodi)identifikues i artikullit të ofruar, i shënuar me një shenjë dalluese.

Nr. Emri i kompanisë prodhuese / i distributorit të autorizuar Emertimi i katalogut të prodhuesit Nr. i faqes Nr. Identifikues i artikullit”

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1696/1 prot., datë 01.06.2026, të korrigjuar, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “VASAA” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1696 prot, datë 01.06.2026.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 314 prot.,datë 09.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1696/6 prot., datë dhe 11.06.2026 prot., me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik VASAA shpk” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i KSHA-së lidhur me shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “VASAA” SHPK ku rezulton se ankesa e tij është refuzuar.

II.9. Në datën 12.06.2026 pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar më shkresën nr. 1669/7 prot “Formulari i Paraqitjes së Argumentave nga Operatori Ekonomik “VASAA SHPK”, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar lidhur me vendimin e KSHA-së.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë, në cilësinë e subjektit të interesuar, në përputhje me nenin 113 të LPP-së i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “VASAA” SHPK për skualifikimin e ofertës së tij me arsyet: OE VASAA SH.P.K. në përmbushje të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku bazuar në Nenin 26 pika 2 gërma h) dhe i) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit publik” duhet të deklarojë të dhënat e sakta të një automjeti të përshtatshëm për transportin e mallit objekt prokurimi dhe të dhënat e sakta të një punonjësi inxhinieri Elektrik të diplomuar në Inxhinieri Elektrike i punësuar në subjektin ofertues :

Konstatojmë se në dokumentacionin e ngarkuar elektronikisht nga O.E. VASAA sh.p.k. tek seksionet e posaçme të Formularit të Vetëdeklarimit të deklarimit të disponimit të fuqisë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e kontratës dhe mjeteve të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, është deklaruar se i disponon por nuk janë deklaruar të dhëna të sakta të tyre me qëllim vlerësimin e tyre në raport me dokumentacionin provues që do të dorëzojë ofertuesi nëse do të kualifikohet i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

OE nuk ka përmbushur kriterin 1 sipas përcaktimeve të Nenit 26 pika 2 gërma (h) dhe (i) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 82 të LPP, për këto arsye OE VASAA SH.P.K. do të skualifikohet., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 të dokumenteve standarde të tenderit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 3 “Kapaciteti teknik dhe profesional:”, pika 3.2 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

“3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë :

- Një automjet të përshtatshëm, për transportin e mallit;

Për të cilat duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtëm :

-Aktin e pronësisë së mjetit përkatës

Ose

-Kontratën noteriale të marrjes me qera të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo me qera) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit Teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Ky kriter do të përmbushet nga O.E. me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjetit, dorezohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

III.1.3. Në shtojcën 8 të dokumenteve standarde të tenderit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 3 “Kapaciteti teknik dhe profesional:”, pika 3.4 autoriteti kontraktor ka përcaktuar

3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një punonjës Inxhinier Elektrik të diplomuar në Inxhinieri Elektrike, të provuar përmes diplomës në këtë fushë, kontratës së punës dhe listëpagesave nga sigurimet shoqërore.

Ky kriter do të përmbushet nga O.E. me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues : diploma; kontratë pune dhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore, për vërtetimin e kualifikimit dhe punësimit të punonjësit, dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “VASAA” SHPK në përmbushje të kriterit sa më lart ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Dokumenta_Fakti pdf (- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të operatorit ekonomik “VASAA” SHPK.)

Ku në seksionin Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen) ka deklaruar si më poshtë:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>
Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ Profili i punonjësve <u>_ING.ELEKTRIK_</u> <u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

III.1.5. Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.1.6. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
 - b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
 - c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
- 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*
- 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve*

ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.1.7. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: 1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pagtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim.

III.1.8. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

III.1.9. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.10. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij . Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

III.1.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë

kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.12. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vihet re, se në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Konkretisht, nisur nga arsyeja e skualifikimit, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 3.2 dhe 3.4 të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar që operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se disponojnë *Një automjet të përshtatshëm*, për transportin e mallit dhe *një punonjës Inxhinier Elektrik*, dhe ku në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë për punonjësit emër/mbiemër, profilin e punës, numrin dhe datën e kontratës individuale të punës, si dhe numrin e diplomës dhe listëpagesën esigurimeve shoqërore.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes “VASAA” SHPK, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatohet, se në lidhje me kërkesën për një punonjës Inxhinier Elektrik, operatori ekonomik “VASAA” SHPK ka deklaruar në *pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate”*, se disponon punonjës inxhinier elektrik pa deklaruar emrin, apo datën e kontratës së punës, si dhe numrin e diplomës.

Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve, duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 9 të DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, plotësimi i kësaj deklarate do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi.

Në rastin konkret referuar dhe kërkesës së autoritetit kontraktor në DST operatori ekonomik ka deklaruar profilin e punonjësit të kërkuar në pikën 3.2 të DST inxhinier elektrik por pa përcaktuar të dhënat e plota të personit.

Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duhet t'i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se deklarimi i punonjësve të profilit “inxhinier elektrik”, por pa përcaktuar të dhënat e plota të personit në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell mospërmbushjen e kriterëve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 3.2 të kapacitetit teknik.

Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Lidhur me kriterin tjetër të kualifikimit, konkretisht pikën 3.2 të 'Kapacitetit Teknik', Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të vërtetojnë disponimin e një automjeti të përshtatshëm për transportin e mallit. Sipas Dokumenteve Standarde të Tenderit, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Deklarata B), operatorët duhet të deklarojnë aktin e pronësisë së mjetit ose kontratën noteriale të qirasë, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së qiradhënësit. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik ankimues “VASAA” SHPK, konstatohet se në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Pjesa III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika B), shoqëria ka deklaruar vetëm në mënyrë të përgjithshme se “disponon makineri e mjete”. Operatori Ekonomik ka dështuar të specifikojë të dhënat funksionale dhe identifikuese të mjetit, si: llojin, targën, si dhe mënyrën e posedimit të tij (pronësi apo qira). Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se ky deklarim i mangët nuk bën të mundur identifikimin e mjetit dhe as verifikimin paraprak të përmbushjes së kërkesave të DST-së. Për këtë arsye, argumentimi i Autoritetit Kontraktor për mosplotësimin e këtij kriteri qëndron dhe oferta e operatorit “VASAA” SHPK nuk konsiderohet e rregullt.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me arsyet e tjera të skualifikimit të operatorit ekonomik “VASAA” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërm i ankimuesit qëndron pjesërisht, dhe gjendja faktike dhe juridike e tij pas arsyetimit të KPP do të jetë i skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera, nuk do ta ndryshojnë gjendjen juridike të tij, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

III.3. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “VASAA” SHPK në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Kejdi Solar” SHPK në këtë procedurë prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se,

III.3.1. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.3.2. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.*

III.3.3. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (legjitimimi locus standi), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t'u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar.

III.3.5. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin, vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (përkundrejt atij imagjinar), nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “VASAA” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar -Mall”, me Nr. REF-83274-04-24-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 7,493,400 (shtatëmilionë e katërqind e nëntëdhjetë e tremijë e katërqind) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Sherbimeve Publike Urbane Elbasan.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Nertil Kanina

Anëtar
Edvin Simo

Kryetar
Ismail Shehu

